



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1389 Prot.

Tiranë, më datë 08.11.2023

VENDIM
Nr. 547 , datë 08.11.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, Vendimit Nr. 220, datë 07.04.2021 “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike” dhe “Regullorja e arkeologut”, Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.11.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Lugina e Poshtme e Drinit në Mesjetë”, në kuadër të projekteve kërkimore – shkencore në vazhdim, me drejtues projekti prof. Elvana Metalla, me zhvillues **AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE;**
 2. Para fillimit të projektit të bëhet njoftimi zyrtar pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
 3. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së dhe IKRTK-së;
 4. Dokumentacioni i hartuar në kuadër të këtij projekti për vitin 2023 të dorëzohet pranë IKTK-së;
 5. Afati përfundimtar i punimeve është një vit nga miratimi në KKTKM;
 6. Afati përfundimtar i punëve do të jetë sipas planit të punës të depozituar në IKTK;
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

